



Pranuar / Dorezuar Punimjeve/Prodato Received/Delivery	28 - 09 2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypje Printeg Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SRANSJK	5739/2022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.712/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.712/2022 të datës 18.08.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë e Kamenicës, kundër organit të punësimit Komunës së Kamenicës në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 28.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.712/2022 e datës 18.08.2022 e parashtruar nga ankuesi.
- II. **ANULOHET** procedura e rekrutimit-konkursi i shpallur sipas njoftimit të datës 12.04.2022 me numër reference RN00008758 për emrin e grupit „Specialistë të Ekonomisë”, për pozitën e punës „Zyrtar për Promovimin e Turizmit” në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporë, në Komunën e Kamenicës si dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.
- III. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Obiliqit që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Komuna e Kamenicës duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 12.04.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 03.05.2022 ka shpallur për aplikim konkursin e jashtëm për emrin e grupit „Specialistë të Ekonomisë” me numër të referencës RN00008758 për pozitën “Zyrtar për Promovimin e Turizmit” në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporë, për klasën e pozitës Profesional 2.

Ankuesi me datën 10.05.2022 ka aplikuar në konkursin e lartcekur, në të cilën procedurë ka qenë i përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit dhe pas intervistës me gojë, bazuar në njoftimin me numër Nr.98 të datës 01.08.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Kamenicës, i njëjti është njoftuar lidhur me pikët e arritura, gjithsejtë 81.40 pikë, duke u renditur i dyti (2) në listën përfundimtare.

I pa kënaqur me rezultatin përfundimtar mbi përzgjedhjen e kandidatëve fitues, me datën 02.08.2022, ankuesi ka parashtruar ankesë tek Komisioni për Vlerësim, me pretendimet ankimore se nuk është bërë vlerësimi i përgatitjes akademike drejtimi siç është kërkuar me konkurs, respektivisht është kërkuar „Specialistë i Ekonomisë” ndërsa pranohet „Gjeograf”, nuk është bërë vlerësim real dhe i drejte i përvojës së punës dhe i jetëshkrimit apo CV-së së kandidatëve gjegjesisht ankuesi pretendon se është vlerësuar me paragjyqime.

Komisioni për vlerësim në Komunën e Kamenicës përgjegjës për vlerësimin e procedurave të lartcekura me datën 04.08.2022, ka nxjerrë Vendim me numër Nr.02-24690, me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa pranueshme dhe e ka lënë në fuqi Njoftimin lidhur me rezultatin e arritur në testin me shkrim të kandidatëve të shpërndarë në HRMIS.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e Komisionit të Vlerësimit në Komunën e Kamenicës lidhur me refuzimin e ankesës së tij, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 18.08.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4782/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se nuk është bërë vlerësimi i përgatitjes akademike drejtimi siç është kërkuar me konkurs, respektivisht është kërkuar „Specialistë i Ekonomisë” ndërsa pranohet „Gjeograf”, nuk është bërë vlerësim real dhe i drejte i përvojës së punës dhe i jetëshkrimit apo CV-së së kandidatëve gjegjesisht ankuesi pretendon se është vlerësuar me paragjyqime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 19.08.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Kamenicës, ndërsa me datën 01.08.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Kamenicës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me Nr.Prot:4782/2022 të datës 18.08.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e konkursit me numër të referencës RN00008758 të datës 12.04.2022; Formularin për kërkesë apo ankesë të datës 01.09.2022 nga ankuesi; Vendimin Nr.24690 të datës 04.08.2022 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Suharekës; Cv-në e ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 19.08.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 01.09.2022 nga Komuna e Kamenicës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës; Aplikacionin e kandidatës të datës 06.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës dhe certifikatën nga gjykata; Njoftimin me Nr.98 të datës 01.08.2022 lidhur me rezultatet e vlerësimit nga njësia e personelit të Komunës së Kamenicës; Përmbledhjen e vlerësimit të datës 22.08.2022 nga kryesuesi i komisionit; Kopjen e konkursit me numër të referencës RN00006628 të datës 22.04.2021; Ankesën e ankuesit me numër Nr.24293 të datës 02.08.2022 për tek komisioni i vlerësimit; Njoftimin me numër 01Nr.12944 të datës 17.05.2021; Listën e aplikantëve nga SIMBNJ; Aplikacionin e kandidatit të datës 06.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës; Aplikacionin e kandidatit Astrit Agaj të datës 05.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës; Aplikacionin e kandidatit të datës 09.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës; Aplikacionin e kandidatit

[redacted] të datës 10.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës; Aplikacionin e kandidatës [redacted] të datës 06.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës; Aplikacionin e kandidatës [redacted] të datës 04.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës; Aplikacionin e kandidatit [redacted] të datës 06.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës; Aplikacionin e kandidatit [redacted] të datës 10.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës dhe certifikatën nga gjykata; Aplikacionin e kandidatës [redacted] të datës 10.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës dhe certifikatën nga gjykata; Aplikacionin e kandidatit [redacted] të datës 04.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës; Aplikacionin e kandidatit [redacted] të datës 04.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale; Aplikacionin e kandidatës [redacted] të datës 08.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës dhe certifikatën nga gjykata.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, sipas shkresave të lëndës ka gjetur se Komuna e Kamenicës sipas njoftimit datës 12.04.2022 ka shpallur konkursin me numër referencë RN00008758 me afat për aplikim nga data 03.05.2022 deri me datë 10.05.2022, për grupin, „Specialistë të Ekonomisë” për pozitën e punës “Zyrtar për Promovimin e Turizmit” në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporë, për klasën e pozitës Profesional 2, bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar pesëmbëdhjetë (15) kandidatë, ndërsa në listën e ngushtë janë përzgjedhur trembëdhjetë (13) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesi i cili ka marrë pjesë në të gjitha fazat të konkurrimit, respektivisht në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë i mbajtur. Sipas listës përfundimtare të Komisionit të Pranimin kandidati me i vlerësuar duke u renditur si i pari në listë është [redacted] me gjithsej 85.00 pikë të përgjithshme nga vlerësimi i testi me shkrim, jetëshkrimit dhe intervistës me goje, ndërsa ankuesi është vlerësuar si kandidati i dytë me gjithsej 81.40 pikë. Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Kamenicës, më datë 01.08.2022 ka bërë publikimin e njoftimit për përfundimin e vlerësimit dhe renditjen përfundimtare të kandidateve.

Ankuesi i pakënaqur me Njoftimin e datës 01.08.2022, parashtron ankesë më datë 02.08.2022 pranë Komisionit të Pranimin i cili me Vendimin Nr.02-24690 të datë 04.08.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi njoftimin për përfundimin e vlerësimit dhe renditjen përfundimtare të kandidateve të datës 01.08.2022.

Ankuesi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke kundërshtuar Vendimin Nr.02-24690 të datës 04.08.2022 të Komisionit të Pranimin, me pretendimet ankimore se ka pas shkelje ligjore lidhur me procedurën rekrutuese për pozitën e punës „Specialistë të Ekonomisë”, që nga faza e verifikimit të aplikacioneve e deri të shpallja e rezultatit përfundimtar, gjegjësisht ankuesi pretendon se nuk është bërë vlerësimi i përgatitjes akademike drejtimi perkates sipas konkursit, respektivisht eshte kerkuar, „Specialistë i Ekonomisë” ndërsa pranohet „Gjeograf”, nuk është bërë vlerësim real dhe i drejte i përvojës së punës dhe i jetëshkrimit apo CV-së së kandidateve, ankuesi pretendon se është vlerësuar me paragjytime.

Pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se kriteret e konkursit për emrin e grupit „Specialist të Ekonomisë”, në Komunën e Kamenicës, i shpallur sipas konkursit me numër të referencës RN00008758 për pozitën

“Zyrtar për Promovimin e Turizmit” në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporë, kanë qenë si në vijim:

- **Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.**
- **Kualifikime të posaçme:**
- **Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvijë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së shpalljes së konkursit dhe zhvillimit të procedurave të rekrutimit deri në fazën kur ankuesi ka parashtruar ankesë, ju referua dispozitave të Rregullore (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe rrjedhimisht duke u bazuar në **Shtojcën 2** të kësaj Rregullore, për emrin e grupit „Specialistë të Ekonomisë” e renditur me kodin e grupit 4, në këtë rregullore në të cilën janë përcaktuar kriteret lidhur me fushën e kërkuar të arsimit për secilën kategori të shërbimit civil, konkretisht për emrin e grupit „Specialistë të Ekonomisë” fusha e kërkuar e arsimit është ajo “Ekonomik (pavarësisht nga specialiteti)”, ndërsa sipas konkursit me numër referencë RN00008758 të shpallur me datën 12.04.2022, për emrin e grupit „Specialistë të Ekonomisë”, nga Komuna e Kamenicës si fushë e arsimit tek kërkesat e përgjithshme formale sipas kushteve të konkursit, nuk është përfshirë fare drejtimi apo fusha e caktuar e arsimit të kërkuar, por është përcaktuar, **Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to**, e që sipas vlerësimit të Kolegjit organi i punësimit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Rregullore (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, pasi që kriteret e përcaktuara me konkurs nuk janë në harmoni me kriteret e përcaktuara me këtë rregullore andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se me rastin e mos përfshirjes së fushës së arsimit “Ekonomik (pavarësisht nga specialiteti)” si kriter të konkursit për emrin e grupit „Specialist të Ekonomisë” siç përcaktohet me dispozitat e kësaj rregulloreje, Komuna e Kamenicës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil si dhe në kundërshtim me dispozitat e 10 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 dhe 1.3 dhe paragrafin 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës e cila përcakton se: **„Shpallja e konkurimit për një Grup të caktuar përmban, të paktën, këto të dhëna: 1.2. Kërkesat e përgjithshme për pranim sipas nenit 8 të LZP; 1.3. kërkesat e përgjithshme formale; 3. Kushtet për aplikim, në pajtim me paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të këtij neni, përfshijnë kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë në pajtim me nenin 8 të Ligjit dhe kërkesat e veçanta të pranimin në Grupin për të cilin zhvillohet konkurimi, të përcaktuara sipas dispozitave të Rregullores për klasifikimin e punëve në shërbimin civil**, me këtë nënkuptohet se nuk mund të bëhet asnjë ndryshim në shpalljen e konkursit nga ajo që përcaktohet me Rregulloren (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Duke marrë parasysh këtë fakt, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komuna e Kamenicës, me rastin e mos përfshirjes së fushës së arsimit-drejtimit të caktuar në konkursin e shpallur të datës 12.04.2022 për emrin e grupit „Specialistë të Ekonomisë” për pozitën “Zyrtar për Promovimin e Turizmit” në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporë”, e ka bërë në kundërshtim me Rregulloren (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 10 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë si dhe analizimit të dispozitave ligjore lidhur me kushtet dhe kriteret e pranimin në shërbimin civil, duke marrë për bazë edhe konstatimet e pasqyruara si në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar se konkursi i shpallur me datën 12.04.2022 sipas numrit të referencës RN00008758 për emrin e grupit „Specialistë të Ekonomisë” nga Komuna e Kamenicës është bërë në kundërshtim me nenin 10 paragrafin 1 nën paragrafët 1.2, 1.3 dhe paragrafin 3 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe mbi këtë bazë ka vendosur të anulojë konkursin e lartë cekur si dhe të shfuqizojë

çdo akt tjetër administrativ që rrjedh nga kjo procedurë e rekrutimit, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar mbi bazën e kësaj të gjeture, ndërsa Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar më tej në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, meqenëse shpallja e konkursit nuk ka qenë në harmoni me dispozitat e akteve ligjore të përcaktuar si më lartë.

Nisur nga konstatimet si me lartë, Kolegji duke u bazuar në nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konstaton se një procedurë rekrutimi e përfshirë më shkelje të dispozitave materiale konsiderohet procedurë e paligjshme, kështu që me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.712/2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Ardita Perçuku-Shyti
Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Malsore Gashi-Bajraktari
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.